



MISIONI SHQIPTAR

E Lumja Nënë Tereza

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Të gjithë shenjtërit

1 Nëntor 2015



Jezusi, kur pa turmën, u ngjit në mal. Kur u ul, iu afruan nxënësit e tij. Atëherë mori fjalën dhe i mësoi duke thënë:

“Lum skamnorët në shpirt, sepse e tyre është Mbretëria e qiejve! Lum ata që qajnë, sepse do të ngushëllohen! Lum ata që janë të butë, sepse do ta trashëgojnë tokën! Lum ata që kanë uri e etje për drejtësi, sepse do të ngihen! Lum të mëshirshmit, sepse do të gjejnë mëshirë!

Lum ata që janë të pastër në zemër, sepse do ta shohin Hyjin! Lum pajtuesit, sepse do të quhen bijtë e Hyjit! Lum ata që salvohen pse kryejnë çka Hyji kërkon, sepse e tyre është Mbretëria e qiejve! Të lumët ju kur t’ju shajnë e t’ju salvojnë dhe kur, për shkak timin, t’i thonë të gjitha të zezat kundër jush, por në rrenë! Gëzohuni e galdoni, sepse i madh do të jetë shpërblimi juaj në qiell! Ja po, kështu i salvuan edhe profetët para jush!” *Mt 5, 1-12*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 pm te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: www.ourladyofmm.com

Kalendari liturgjik...

02 nëntor	Shpirtrat e purgatorit
03 nëntor	Shen Martini nga Porres
04 nëntor	Shen Karl Borromeo
05 nëntor	Te gjithë shenjterit dhe te lumturit e Shqiperise

Viti 2015, kalendar aktivitetesh...

Te shtunen **28 Nëntor** Party festa e Pavaresise; te shtunen **19 Dhjetor** Christmas Party.

2 Nëntor, Mesha per Purgatorë...

Te henen **2 Nentor ne oren 7:45pm** kremtohet Mesha per shpirtrat e besimtareve ne purgator.

Haku Kishes 2015...

Deri tani kane dhene:

Aleks	Coku
Alfred	Shllaku
Altin	Miri
Anton	Malaj
Anton	Tinaj
Anton	Brunga
Arben	Pepa
Arben	Toma
Astrit	Simeqi
Augustin	Bakaj
Beniamin	Hasko
Dritan	Lumaj
Edi	Linadi
Eduard	Shkreli

Elbert	Gashi
Fatmir	Qosaj
Franc	Shestani
Fred	Kalaj
Gac	Gjoka
Gezim	Vushaj
Gezim	Lanazi
Gjelosh	Vushaj
Gjergj	Gjinaj
Gjovalin	Ftoni
Ilir	Shyti
Ilir	Daka
Kreshnik	Kapaj
Ladi	Lumaj
Lec	Gashaj
Lek	Tarazhi
Leke	Kapllaj
Luk	Gjolaj
Lule	Tinaj
Marash	Martinaj
Marin	Muzhani
Mario	Martini
Martin	Pjetri
Mhill	Ftoni
Mhill	Bregu
Nik	Biqi
Nikolin	Vukelaj
Nikolle	Lumaj
Nua	Selmani
Nush	Kaçaj
Pal	Rransburgaj
Paulin	Gjerkaj
Paulin	Lukani
Pjeter&Bep	Dreshaj
Prek	Spaqi
Prek	Lekaj
Preke	Gjonaj
Prel	Pepushaj
Shpend	Pllumaj
Sokol	Sokoli
Sokol	Ujka
Taulant/Elvis	Gjerkaj
Ton	Vocaj
Viktor	Pleti
Vitor	Mernacaj
Vladimir	Doda
Zef	Lulaj

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Kishes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese gjate vitit. Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**



DEAR JESUS,

help me to spread Thy fragrance everywhere I go. Flood my soul with Thy spirit and love. Penetrate and possess my whole being so utterly that all my life may only be a radiance of Thine. Shine through me and be so in me that every soul I come in contact with may feel Thy presence in my soul. Let them look up and see no longer me but only Jesus. Stay with me and then I shall begin to shine as you shine, so to shine as to be a light to others.

Besimi mbi Purgatorin sipas Kishes Katolike

Purgatori është vendi i arritjes së asaj përsosmërie të cilën i krishteri nuk e ka arritur mbi tokë!

Para së gjithash duhet thënë se Shpirti i përket Hyjit dhe vetëm Ai e din, e cakton dhe vendosë mbi shortin dhe gjendjen e tij.

Disa shpjegime mbi Purgatorin:

KATEKIZMI I KISHES KATOLIKE

III. Purgatori

1030 - Ata që vdesin në hir ose në miqësi me Hyjin, por që nuk janë plotësisht të pastruar në shpirtin e tyre, pas vdekjes i nënshtrohen një

pastrimi të lehtë, deri sa të fitojnë shenjtërinë e duhur për të bërë pjesëtar të gezimit të amshuar në qiell.

a) Domethënja e fjalës "Purgator"

Fjala "Purgator" vjen nga folja latine "purgare" që do të thotë "për të pastruar", ndërsa "purgatori" është vendi ku kryhet ky "pastrim".

Mësimi i Kishës, me fjalën "purgator", nënkupton vendin e pastrimit të mëkateve të lehta që ka në shpirt njeriu në momentin kur kalon nga kjo jetë në jetën e pasosur.

Sipas mëimit të Kishës Purgatori është vendi i arritjes së asaj përsosmërie të cilën i krishteri nuk e ka arritur mbi tokë. Si rrjedhojë, në momentin kur kjo përsosmëri arrihet, shpirti hyn në Parajsë, aty ku jo vetëm e shikon, por edhe e përjeton për amshim Hyjin dhe lavdinë e tij.

b) Një nder bazat biblike, historike dhe dogmatike të mëimit të Kishës mbi Purgatorin

"Këndeje të gjithë zunë t'i japin lavdi Zotit, Gjykatësit të drejtë, i cili qet në dritë edhe atë çka është më e fshehur dhe filluan të luten që mëkati i bërë të falej krejtësisht. Atëherë trimi kreshnik Juda i qortoi njerëzit të ruhen të pastër nga mëkati, pasi kishin parasysh çfarë i kishte gjetur për shkak të mëkatit ata që ishin vranë. E si i mblodhi nga secili burrë dy mijë drahma të argjendta, i dërgoi në Jeruzalem të kushtohet flia për mëkat duke vepruar kështu shumë mirë e bujarisht, i shtyrë nga mendimi i ringjalljes. E, njëmend, po të mos kishte shpresuar se do të ringjallen ata që u vranë, do të kishte qenë e tepërt dhe e kotë të luteshin për të vdekur. Mandej ai e kishte parasysh se një shpërblim tepër i bukur i priste ata që vdesin në hirin e Zotit: mendim ky i shenjtë e i përshtypshëm. Ja, pra, pse dha të kushtohen flia shpërblimi, që të çlirohen nga mëkati".

Kjo pjesë biblike, të cilën e gjerjmë në

Besëlidhjen e Vjetër, saktësisht në Librin e dytë të Makabenjëve, kapitulli 12, rreshtat 42-46, tregon se ndërmjetësimi me lutje tek Hyji për shpirtërat e të vdekurve ishte i pranishëm ndë popullin e Hyjit, por që bëhet ende më i qartë dhe stabil në rastin e Makabenjëve. Ndërsa sa për besimin në Ringjallje, ky nuk ka munguar kurrë, sidomos në rymën e farisenjëve, besimi i të cilëve bazohet pikërisht në shpresën e ringjalljes. Në konceptimin e Besëlidhjes së Vjetër, gjejmë kryesisht fjalën "Sheol" (Nëntoka, gjiri i tokës), që nuk ka vetëm kuptim negativ, por tregon kryesisht vendin se ku shkojnë të vdekurit. "Sheol", më shumë se "vend" në kuptimin gjeografik, tregon një gjendje. Në këtë mënyrë ka kuptim edhe ajo që **gjejmë në Librin e Siracidit, kapitulli 7, rreshti 37: "Ji dorëdhënë me të gjithë të gjallët, por as të vdekurit mos ia moho hirin", ftesë kjo për t'u lutur dhe për të sakrifikuar për shpirtërat e të vdekurve,** në kuptimin e nevojës për t'u pastruar nga mëkati (purgare – purgator). **Kjo tregon** se idea e shoqërimit me lutje dhe sakrifica të të vdekurve, është e pranishme që në Besëlidhjen e Vjetër.

Në Besëlidhjen e Re gjejmë një pjesë interesante së pari në Letrën e parë të shën Palit drejtuar Korintasve, kapitulli 3, rreshtat 12-15, pjesë kjo në të cilën Apostulli i referohet Gjyqit të mbramë: "Si kush të ndërtojë mbi këtë themel me ar, me argjend, me gur të paçmueshëm, me dru, me sanë, me kashtë – vepra e secilit do të dalë në dritë. Ajo Ditë do ta tregojë sepse do të vijë me zjarr, e zjarri do ta provojë cilësinë e veprës së secilit. Ai, vepra e të cilit do të qëndrojë, do të marrë shpërblimin".

"Zjarri" vlen njëkohësisht edhe si simbol biblik për të shprehur dashurinë e Hyjit. Në fakt, ajo që pastron është vetëm dashuria e kjo dashuri është e zjarrtë, pra asgjëson atë që është e ligsha dhe e paqëndrueshmja duke i bërë vend të pastrës dhe të amshueshmes. Periudha e purgatorit është periudha e pritjes derisa ky proces pastrimi të plotësohet, për të kaluar në amshimin e Hyjit.

Patristika e vontë, kryesisht Origene, në veprën

e tij Contra Celsius, kapitulli 5, rreshti 15, e vën "zjarrin" në marrëdhënje me "ndriçimin", pra me Shpëtimin e amshuar. "Ndriçimi" është termi patristiko-biblik që tregon Lavdinë e Hyjit, pjesëmarrjen në këtë Lavdi nga ana e njeriut dhe, si rrjedhojë, Shpëtimin e amshuar të njeriut.

Ky mësimi kristalizohet përfundimisht në Kishë në shekullin XI. duke ppohuar qartazi para së gjithash dallimin mes mëkateve vdekjeprurëse (në gjuhën e popullit: mëkatet e rënda) dhe mëkatet e zakonta (në gjuhën e popullit: mëkatet e lehta). Ky dallim është i domosdoshëm për faktin se mësimi mbi Purgatorin i referohet vetëm rastit të dytë, pra rastit kur njeriu vdes me mëkatet e lehta dhe Purgatori nuk është gjendje definitive, por përgatitje definitive, mbas së cilës kalohet në gjendjen e lavdishme, pra në amshimin e Hyjit. Ndërsa, në rastin e parë, ku fjala është për mëkate vdekjeprurëse (= të rënda), aty nuk bëhet fjalë për Purgator sepse liria personale e njeriut ka vendosur vetë të jetoj larg dhe pa Hyjin, pra të mos i bë vend Hyjit në jetën e tij, gjë kjo që ka si pasojë mungesën e amshueshme të Hyjit. **Duhet këtu edhe të kujtojmë, se mëkat i rëndë është atëherë kur bëhet një vepër e keqe, kundër Zotit, me vendosje personale të lirë dhe vetëdije të plotë dhe kur me vetëdashje nuk pranohet pendimi, kthimi, por lejohet që të vdiset në këtë gjendje.**

Në pikëpamjen dogmatike, pra të mësimin kishtar, gjë kjo që është konfirmuar në Koncilin e Trentos, rolin kryesor në aspektin biblik e luan idea e Besëlidhjes së Vjetër mbi Sheolin, ndërsa në aspektin e Traditës e luan Patristika e vontë.

RIGHT AT HOME
REALTY INC. BROKERAGE

Giovanni Selmani
Sales Representative
Direct:
647.500.3875

Office: 905.565.9200
Fax: 905.565.6677
E-Mail: gioselmani@hotmail.com
www.rightathomerealty.com

7045 Edwards Blvd., Suite 401
Mississauga, ON L5S 1X2